

Në bazë të nenit 172 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, shpallet

## **KONKURS**

Për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore shkencore në Universitetin e Tetovës

Shpallet Konkurs për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore shkencore në Universitetin e Tetovës, si në vijim:

### **FAKULTETI JURIDIK**

1. Një mësimdhënës për lëndët:
  - Politika e jashtme
  - Etika dhe deontologjia politike
  - Veprimtaria diplomatike dhe konsulare.

### **FAKULTETI FILOZOFIK**

1. Një mësimdhënës për lëndët:
  - Sistemet politike
  - Sociologjia e zgjedhjeve
  - Teoritë dhe modelet e demokracisë
  - Sociologjia e barazisë gjinore.

### **FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE**

1. Një mësimdhënës për lëndët:
  - Lojërat elementare
  - Edukim special fizik I.

### **FAKULTETI I SHKENCAVE TË ZBATUARA**

1. Një mësimdhënës për lëndët:
  - Historia e arkitekturës I
  - Historia e arkitekturës II
  - Historia e arkitekturës III.

### **FAKULTETI FILOLOGJIK**

#### **Programi studimor Gjuhë dhe Letërsi Shqipe**

1. Një mësimdhënës për lëndët:
  - Metodologjia e punës shkencore I
  - Metodologjia e punës shkencore II
  - Një autor – Faik Konica.

## **FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE**

1. Një mësimdhënës për lëndët:
  - Fizika e përgjithshme
  - Fizika mjekësore (në programin studimor Mjekësi e përgjithshme)
  - Fizika e trupit të ngurtë.
2. Një mësimdhënës për lëndët:
  - Interaksion njeri – kompjuter
  - Inteligjencia biznesore
  - Sistemet kompjuterike bashkëkohore.
3. Një mësimdhënës për lëndët:
  - Komponentët softuerike
  - Mësimi elektronik
  - Menaxhimi me projektet softuerike.
4. Një mësimdhënës për lëndët:
  - Mikroprocesorët dhe mikrokontrollët
  - Elektronika
  - Teknologjia informative (në Fakultetin e Administratë Biznesit).
5. Një mësimdhënës për lëndët:
  - Analizë instrumentale farmaceutike (në programin studimor Farmaci)
  - Analizë instrumentale II (në programin studimor Kimi)
  - Kimia e ambientit jetësor (në programin studimor Kimi).
6. Një mësimdhënës për lëndët:
  - Matematikë numerike (në programin studimor Matematikë)
  - Programim linear (në programin studimor Matematikë)
  - Analizë numerike (në programin studimor Matematikë).

### **Kushtet për thirrjen mësimore-shkencore docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar:**

- Thirrje mësimore – shkencore, me Vendim të organit kompetent, nëse e posedon;
- Diplomë për gradën shkencore doktor i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;
- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- Biografi e shkurtër;
- Ta dorëzojë punimin e doktoratës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Certifikatë e shtetësisë.

\*Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, të parapara me nenin 166 të Ligjit për arsimin e lartë.

\*Fletëparaqitjen bashkë me dokumentet e nevojshme, kandidati duhet t'i dorëzojë në afat prej 5 ditë pune, nga dita e shpalljes së Konkursit, në Rektoratit e Universitetit të Tetovës, në adresën: Rektorati i Universitetit të Tetovës, Rr. e Ilindenit, p.n. Tetovë.

**Universiteti i Tetovës**